



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

EDICIONI I NËNTË

DHJETOR 2019





QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

EDICIONI I NËNTË

Autore: Donika Marku

Metodolog: Mentor Vrajolli

Rishikimi i Brendshëm: Mentor Vrajolli dhe Plator Avdiu

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i të gjitha materialeve që botohen nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutem kontaktoni në: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të nxjerra nga të anketuarit dhe ai vetëm demonstroi mënyrën se si njerëzit i perceptojnë institucionet. Raporti në asnjë mënyrë nuk paraqet ndonjë vlerësim përfundimtar të cilësisë së punës së institucioneve të përfshira në këtë studim. Ai do të shërbejë si instrument për to në adresimin e mangësive të mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë.

Mendimet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e fondacionit Ndhimja Kombëtare për Demokraci (NED)

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE	6
LISTA E SHKURTESAVE	7
GJETJET KRYESORE TË BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË	8
KAPITULLI 1 - BESUESHMËRIA NË INSTITUCIONET E KOSOVËS	10
1.1. BESUESHMËRIA NË INSTITUCIONET E SIGURISË	11
1.2. BESUESHMËRIA NË INSTITUCIONET E DREJTËSISË	18
1.3. BESUESHMËRIA NË KUVEND, QEVERI DHE KOMUNA	21
KAPITULLI 2 - PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT NË INSTITUCIONET E KOSOVËS	27
METODOLOGJIA	31
ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	31

MIRËNJOHJE

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë i shpreh mirënjohje të veçantë anëtarëve të ekipit për kontributin e tyre të çmuar në hulumtimin në terren.

Ekipi i Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2019 përbehej nga:

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

KORDINATORE TË PROGRAMIT
DONIKA MARKU, TRINGA NAKA

TRAJNER I HULUMTUESVE NË TERREN
SKENDER PERTESHI

KORDINATORËT E HULUMTIMIT NË TERREN
**MARIGONA DUBOVCI, TAULANT BOSHNJAKU,
SHPAT BALAJ, SHPEJTIM PERTESHI,
BARDH KRASNIQI**

VERIFIKIMI I CILËSISË
RRONA MARKU

FUTJA E TË DHËNAVE NË SISTEM
XHYLJETA PESHKU, YLL KASTRATI

EKIPI I HULUMTUESVE NË TERREN

**AGNESA KRASNIQI
AJSHE ABDULLAHU
ARIAN MAVRIQI
ARIOLA KUQI
ARLINDA UKA
ARTINESA SYLMETAJ
BURBUQE KASTRATI
DION SALIHU**

**EDITA FERATI
ELSA HAJRADINI
ELSA LOMA
ENDRIT BINAKAJ
ERDUAN GJYRISHEVCI
FATJONA VESELAJ
JETA ADEMAJ
JONA BERISHA**

**KALTRINA ZHUSHI
KLEMENTINA LAJQI
LEONA TAHIRI
LEUTRIM RAMADANAJ
MALISA ZYMBERI
REA GASHI
SHPEND GASHI
ULPIANA LAJQI**

LISTA E SHKURTESAVE

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
BKS	Barometri Kosovar i Sigurisë
BE	Bashkimi Evropian
DK	Dogana e Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
KK	Kuvendi i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
QK	Qeveria e Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
NED	National Endowment for Democracy
RAE	Romë, Ashkali dhe Egjiptian
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës

GJETJET KRYESORE TË BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një mjet i veçantë, përmes të cilit Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë mat perceptimet publike në Kosovë. Edicioni i nëntë i Barometrit Kosovar të Sigurisë përbëhet nga dy kapituj. Derisa, kapitulli i parë mat perceptimet e qytetarëve lidhur me besueshmërinë në institucionet e sigurisë, drejtësisë, si dhe në institucione të nivelit qendror dhe lokal,¹ kapitulli i dytë interpreton perceptimet e qytetarëve lidhur me korrupsionin në këto institucione.

Perceptimet mbi besueshmërisë në institucionet e shtetit dhe korrupsionin mund të dallojnë varësisht nga etnia², gjinia, zona dhe rajoni i banimit. Krahas kësaj, raporti përmban edhe analizë të kombinuar të të dhënave përtej interpretimit të përgjithshëm, gjë që i mundëson publikut të kenë një pamje të qartë dhe më kuptimplotë rreth besueshmërisë së qytetarëve në institucione. Lidhur me këtë, analizimi i rezultateve të besueshmërisë sipas zonave rurale/urbane, rajoneve gjeografike, përkatësinë etnike e gjinore, si dhe të dhënat e tjera plotësuese lidhur me të anketuarit, do t'i mundësojë audiencës që të vlerësojë dhe analizojë mendimet e qytetarëve të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe drejtësinë në Kosovë përgjatë vitit 2019.

Krahas rezultateve të Barometrin Kosovar të Sigurisë 2019 dalin gjetjet kyçe (sektorale):

- Institucionet e sigurisë vazhdojnë të jenë më të besueshme se ato të drejtësisë dhe qendrore edhe në këtë edicion të Barometrit Kosovar të Sigurisë;
- Institucionet e drejtësisë (gjykatat dhe prokuroria) vazhdojnë të kenë besim më të ulët se ato të sigurisë. Për më tepër, rezultatet e vitit 2019 tregojnë se ka rënie të besueshmërisë së publikut në institucionet e sundimit të ligjit në krahasim me vitin e kaluar;
- Kuvendi dhe Qeveria vazhdojnë të mbesin institucionet më pak të besueshme në sytë e qytetarëve;
- Qeveria e Kosovës ka më së paku besim të qytetarëve nga të gjitha institucionet e matura në këtë edicion të Barometrit. Krahas kësaj, Barometri ka regjistruar se të anketuarit me të ardhura mujore më të ulta i besojnë më shumë Qeverisë se sa ata me të ardhura më të larta;
- Institucionet komunale vazhdojnë të gëzojnë besueshmëri më të lartë se ato qendrore.

1 Paraqitja grafike e analizave përbëhet nga grupimet si: nuk e di, aspak besim, deri diku dhe besim i lartë. Përshkrimi 'deri diku' ngërthen në vete të anketuarit që janë përgjigjur se kanë pak besim dhe deri diku, duke grupuar kështua të anketuarit që kanë shprehur besueshmëri jo të kënaqshme. Përshkrimi 'besim i lartë' ngërthen në vete përqindjen e të anketuarve që janë shprehur se kanë besim dhe shumë besim- duke grupuar të anketuarit që kanë shprehur besueshmëri të kënaqshme ndaj institucioneve.

2 Paraqitja grafike e analizave të kombinuara u referohet komuniteteve etnike jo K-Shqiptar dhe K-Serb si "të tjerë" për arsye se BKS nuk ka një mostër të caktuar për këto komunitete etnike

Krahas gjetjeve të përgjithshme në lidhje me besueshmërisë ndaj sektorëve, rezultatet japin një pasqyrë interesante edhe sa i përket institucionet specifike ku:

- Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdon të jetë institucioni më i besuar nga të gjitha institucionet që Barometri ka matur në këtë edicion;
- Edhe këtë vit, të anketuarit burra i besojnë Forcës së Sigurisë së Kosovës më shumë se gratë;
- Ndonëse me një rënie të vogël prej dy përqind nga viti i kaluar, 59 përqind e të anketuarve kanë shprehur besimin e tyre ndaj Policisë së Kosovës;
- Të anketuarat gra i besojnë më shumë Policisë së Kosovës dhe institucioneve të drejtësisë, duke reflektuar kështu potencialisht një ndjenë të pasigurisë së grave në shoqëri;
- Risi e këtij edicioni të BKS është matja e besimit të qytetarëve edhe ndaj Sherbimit Korrektues të Kosovës dhe Doganave. Rezultatet dëshmojnë besueshmëri të ulët ndaj Sherbimit Korrektues (me 30 përqind) dhe ndaj Doganave besueshmëria nuk ishte aq e kënaqshme (me vetëm 35 përqind).

GJETJET KRYESORE LIDHUR ME KORRUPSIONIN:

- Më shumë se gjysma të anketuarve kanë thënë se i shohin Gjykatat dhe Prokurorinë si të korruptuara. Për të anketuarit, Gjykatat kanë rezultuar të jenë institucioni më i korruptuar në Kosovë;
- Sa i përket perceptimit të publikut lidhur me korrupsionin në komunat e Kosovës, vërehet një rritje këtë vit në raport me vitin e kaluar;
- Forca e Sigurisë së Kosovës shihet si institucioni më së paku i korruptuar;
- Rezultatet e vitit 2019 dëshmojnë se niveli i korrupsionit në polici ka shënuar rënie prej katër përqind në krahasim me vitin 2018;

BESUESHMËRIA NË INSTITUCIONET E KOSOVËS

Edicioni i nëntë i Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) mat besueshmërinë e qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe atyre qendrore e lokale në vend. BKS është program i specializuar i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) për të matur dhe vlerësuar punën e institucioneve duke u bazuar në perceptimet e qytetarëve. Si i tillë, BKS i jep mundësinë politikëbërësve dhe zyrtarëve të këtyre institucioneve që të reflektojnë mbi punën e tyre dhe të ndërmarrin veprime në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale për performancë më të mirë, me qëllim të ngritjes së besueshmërisë së qytetarëve në këto institucione. Krahas kësaj, besueshmëria pasqyron nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në nivelin qendror dhe lokal, por edhe elitën politike në Kosovë në përgjithësi.

Elemente të ndryshme ndikojnë në perceptimet e qytetarëve. Padyshim se qëndrimet e tilla formësohen nga përvoja personale. Megjithatë, duhet theksuar se niveli i besueshmërisë ose mosbesimit ndaj disa institucioneve ose sektorëve nuk është gjithmonë i bazuar në cilësinë e performancës ose në mungesën e saj. Perceptimet e të anketuarve janë goxha elastike apo relative dhe nuk paraqesin gjithmonë gjendjen reale të nje institucioni pasi që në raste të shpeshta, jo gjithmonë, perceptimet janë të bazuara në observim pasiv dhe jo atë aktiv ngase qytetarët i perceptojnë institucionet kryesisht nga kontaktit që kanë me to, duke mos patur shumë informata se si funksionojnë institucionet nga brenda.

Po ashtu, nuk mund të injorohet rëndësia e mediave dhe transparenca/jotransparenca e institucioneve në formësimin e perceptimeve të qytetarëve.

Perceptimet mund të lidhen me karakteristikat personale të të anketuarve si zona urbane/rurale, përkatësia etnike, rajoni, gjinia si dhe të ardhurat mujore. Prandaj, përtej analizave të përgjithshme të të dhënave, ky edicion përfshin edhe analiza të kryqëzuara të besueshmërisë në institucione shtetërore me karakteristika personale.

Ky edicion i hulumtimit të BKS-së e ka matur besimin e qytetarëve në gjithsej 10 institucione kyçe të sigurisë, drejtësisë si dhe ato të nivelit qendror e lokal. Raporti i kategorizon institucione në këto tri grupe si në vijim:

- Institucionet e sigurisë (Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës (PK), Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Dogana e Kosovës (DK) dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK);
- Institucionet e drejtësisë (Prokuroria dhe Gjykatat);
- Institucionet e nivelit qendror dhe lokal (Kuvendi i Kosovës (KK), Qeveria e Kosovës (QK) dhe (Komunat).

1.1. BESUESHMËRIA NË INSTITUCIONET E SIGURISË

Gjatë viteve, BKS në vazhdimësi ka bërë matjen e besueshmërisë në institucionet e sigurisë, si FSK, PK dhe AKI. Një gjë të tillë ky edicion i rregullt e ka bërë edhe këtë vit për të nëntën herë radhazi. Mirëpo, risi e edicionit të BKS për vitin 2019 qëndron në faktin se është bërë matja e besueshmërisë edhe në DK dhe SHKK, përkundër faktit se DK vepron në kuadër të Ministrisë së Financave³ dhe se SHKK vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë të Qeverisë së Kosovës.⁴ Arsya e integritit të këtyre dy mekanizmave shtetërorë në kuadër të institucioneve të sigurisë ndërlidhet me kontributin e tyre në siguri si dhe kundrejt faktit se ato shërbejnë si staf i uniformuar i sigurisë. Krahas kësaj, këta mekanizma shtetërore kanë bashkëpunim të ngushtë me PK⁵ dhe personeli i të dy këtyre institucioneve trajnohet nga Akademia Kosovare e Sigurisë Publike (ASKP).⁶

Institucionet tradicionale⁷ të sigurisë vazhdojnë të kenë besueshmërinë më të lartë nga qytetarët edhe në këtë edicion të BKS. Ngjashëm me edicionin e kaluar, FSK vazhdon të jetë institucioni më i besuar i sigurisë në Kosovë. Për më tepër, FSK ka besueshmërinë më të lartë nga të gjitha institucionet shtetërore që BKS 2019 ka matur. Këtë vit, rezultatet e BKS tregojnë se ka rritje prej katër përqind nga viti i kaluar tek besueshmëria ndaj FSK-së, gjegjësisht 81 përqind e të anketuarve janë shprehur se i besojnë FSK-së. Padyshim se një rritje e tillë ndërlidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me procesin e transformimit të FSK-së në ushtri që ngjau gjatë vitit 2018 me miratimin e pakos së ligjeve për FSK-në dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës nga ligjvënësit e Kuvendit të Kosovës, si dhe me përkrahjen e vazhdueshme të qytetarëve ndaj FSK-në gjatë këtij procesi. Në Pejë është regjistruar besueshmëria më e lartë ndaj FSK-së me rreth 90 përqind, ndërsa besueshmëria më e ulët me rreth 12 përqind është shënuar në Mitrovicë të Veriut. Tek analizat e kryqëzuar është vërejtur se burrat kanë besim më të lartë në FSK se gratë.

Sipas rezultateve të BKS për vitin 2019, në sytë e qytetarëve, PK vazhdon të jetë një nga institucionet më të besueshme në vend. Ndonëse me një rënie të vogël prej dy përqind nga BKS 2018, më shumë se gjysma e të anketuarve (59 përqind) janë shprehur se i besojnë PK-së. Ndërsa, 30 përqind e të anketuarve janë shprehur se kanë besim jo të kënaqshëm në PK. Në anën tjetër, 10 përqind e të anketuarve janë deklaruar se nuk kanë fare besim në këtë institucion. Sipas BKS, të anketuarit në zonat rurale kanë besim më të lartë në PK, ndërsa sa i përket rajoneve, besim më i kënaqshëm ndaj PK është regjistruar në rajonin e Mitrovicës dhe ajo më e ulëta në atë të Mitrovicës së Veriut. Kur jemi tek gjinia, është vërejtur se gratë i besojnë më shumë PK-së se sa të anketuarit burra.

Në anën tjetër edhe në këtë vit, sipas perceptimeve të të anketuarve nga BKS, AKI qëndron si institucioni i sigurisë që gëzon më së paku besim nga qytetarët. Krahas kësaj, AKI ka besueshmëri të ulët edhe në krahasim me institucionet

3 Doganat e Kosovës kontribuojnë në sigurinë e Kosovës duke luftuar aktivitetet ilegale dhe duke rritur sigurinë me prezencë kufitare. Mësoni më shumë rreth misionit të DK në <https://dogana.rks-gov.net/per-doganen/misionit/> si dhe në ODI Nr. 03/L-109 DOGANOR DHE I AKCIZAVE NË KOSOVARË <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2600>.

4 Sipas Ligjit Nr. 04/L-149 Për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, SHKK është "është organ qendror i administratës shtetërore, profesional i pavarur, i uniformuar me grada dhe pjesërisht i armatosur në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë". Në vitin 2018 Sindikata e Shërbimit Korrektues të Kosovës ka kërkuar që kjo zyrtarët e shërbimit korrektues në Ligjin e ri për Paga të trajtohet njëjtë si Policia e Kosovës, pra si shërbyes civil dhe staf i uniformuar i sigurisë së burgjeve. Lexoni më shumë në <https://telegrafi.com/sherbimi-korrektues-kosoves-kerkon-paga-te-njehta-policine/>

5 DK bashkëpunojnë ngushtë me policinë kufitare në baza ditore në pikat kufitare por edhe me sektorë tjerë të policisë për shkëmbim të informatave të ndryshme. Po ashtu, sipas Nenit 8 të KODI Nr. 03/L-109 DOGANOR DHE I AKCIZAVE NË KOSOVARË "Nëse një gjë e tillë kërkohet nga një oficer, atëherë zyrtarët e PK e kanë për detyrë detyrë që të ndihmojnë në zbatimin e ligjit në lidhje me çështjet doganore dhe për çështjet tjera që i caktohen Doganës nga Qeveria e Republikës së Kosovës." SHKK ka bashkëpunim të ngushtë me PK në shkëmbim të informatave, bashkëpunim gjatë sjelljes së burgosurve, gjatë procesit të paraburgimit, lirimimit me kusht si dhe në situata të jashtëzakonshme. Lexoni më tepër në Ligjit Nr. 04/L-149 Për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

6 Më shumë informata rreth trajnimeve profesionale për Zyrtarët Doganor si dhe Zyrtarët Korrektues gjeni në http://www.aksp-ks.net/repository/docs/20190607124809_Katalogu_2019_shqip.pdf


7 BKS i referohet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës si institucione tradicionale të sigurisë

e tjera jo vetëm ato të sigurisë. Vetëm një çerek i të anketuarve, 24.8 për qind, janë shprehur se i besojnë AKI-së, ndërsa rreth 39 për qind e të anketuarve kanë shprehur rezerva duke thënë se i besojnë këtij institucioni deri diku. Në anën tjetër, rreth 22 për qind e të anketuarve nuk i besojnë fare AKI-së. Kjo lë të nënkuptoj që AKI-ja është institucioni i sigurisë më së paku i njohur për qytetarët, gjë që ka ndikim edhe në rezervat e tyre rreth besimit që ata kanë në këtë institucion.⁸ Sipas BKS-së, të anketuarit në zonat rurale kanë besueshmërinë më të madhe në AKI. Krahas kësaj, AKI-së më shumti i besojnë të anketuarit e rajoneve të Pejës, Ferizajt dhe Gjakovës.

Këtë vit, rreth 35 për qind e të anketuarve kanë shprehur besueshmëri të lartë në DK dhe gati 40 për qind e tyre janë shprehur se kanë deri diku besim në këtë institucion. Në anën tjetër, 20 për qind janë shprehur se nuk kanë aspak besim në DK. Ndërkohë, besueshmëria më e madhe ndaj DK është vërejtur në rajonin e Prizrenit. Po ashtu, DK gëzojnë besueshmëri më të lartë tek burrat se sa tek gratë.

Vetëm tre në dhjetë të të anketuarve, apo 30 për qind, kanë besueshmëri të lartë në Shërbimin Korrektues të Kosovës (ShKK).

Në anën tjetër, 16 për qind e të anketuarëve kanë treguar se nuk i besojnë aspak ShKK. Një besueshmëri kaq e ulët mund të ketë buruar nga një numër i madh i faktorëve. Megjithatë, një nga arsyt kryesore padyshim që ndërlidhet me rastin e vdekjes së dyshimtë të aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren që mund të ketë ndikuar në shkallën e besueshmërisë ndaj ShKK.⁹ Një ndër arsyt tjera mund të jetë edhe fakti se për dekada të tëra burgjet në Kosovë, të menaxhuara dhe kontrolluara nga regjimi ish- Jugosllav, kane shërbyer si vende ku janë keqtrajtuar të burgosurit politik dhe qytetarët për këtë fakt ende vazhdojnë të kenë mendime negative ndaj ShKK në përgjithësi. Krahas kësaj, mediat kanë raportuar edhe për raste të korrupsionit, ikjeve me ndihmën e zyrtarëve korrektues¹⁰, kontrabandës si dhe privilegjeve nëpër burgje, që mund të ketë ndikuar në një besueshmëri kaq të ulët të këtij institucioni nga të anketuarit.




8 Lexo më shumë rreth arsyeve që mund të kenë ndikuar në mosbesueshmërinë ndaj AKI në <https://sbunker.net/siguria-bllogje-tematike/90314/pse-kaq-mosbesim-ndaj-aki-se/>


9 Hulumtuesit në terren gjatë në të dy grupet e fokusit të mbajtura kanë thënë se të anketuarit shumë shpesh kanë arsytuar mosbesueshmërinë e tyre ndaj SHKK me vdekjen e Astrit Deharit.

10 Gjatë vitit 2018 dy të burgosur ishin arratisur nga Qendra Korrektuese në Dubravë, me ç'rast dy zyrtarë korrektues ishin suspenduar. Lexoni më detajisht në <https://indeksonline.net/si-u-arratisen-dy-te-burgosurit-nga-dubrava-tregon-sherbimi-korrektues/>




Besimi në FSK sipas gjinisë




Besimi në FSK sipas vendbanimit




Besimi në FSK sipas rajonit




Besimi në FSK sipas kombësisë






Besimi në PK sipas gjinisë




Besimi në PK sipas vendbanimit




Besimi në PK sipas rajonit




Besimi në PK sipas kombësisë




Besimi në AKI sipas gjinisë




Besimi në AKI sipas vendbanimit



Besimi në AKI sipas kombësisë




Besimi në AKI sipas rajonit




Besimi në DK sipas gjinisë




Besimi në DK sipas vendbanimit




Besimi në DK sipas kombësisë




Besimi në DK sipas rajonit




Besimi në SHKK sipas gjinisë Besimi në SHKK sipas vendbanimit



Besimi në SHKK sipas kombësisë



Besimi në SHKK sipas rajonit



1.2 BESUESHMËRIA NË INSTITUCIONET E DREJTËSISË

Institucionet e sistemit të drejtësisë në Kosovë, më saktësisht Gjykatat dhe Prokuroria, edhe më tutje vazhdojnë të ballafaqohen me nivel besueshmërie tejte të ulët krahasuar me ato të sektorit të sigurisë. Rezultatet e BKS për vitin 2019 tregojnë se besueshmëria në Gjykata dhe Prokurori, si dy shtyllat kryesore të sektorit të drejtësisë, ka shënuar rënie këtë vit kur rezultatet krahasohen me ato të vitit të kaluar.¹¹ Kjo nënkupton se trendi i besueshmërisë në këto dy institucione të drejtësisë është në rënie të vazhdueshme dhe atë në mënyrë drastike nëse krahasojme rezultatet e viti 2018 në vitin 2019. Gjë që dëshmon se qytetarët nuk janë aspak të kënaqur më punën e sistemit të drejtësisë në vend.

Përvoja personale qëndron si element kyç në formësimin e perceptimeve rreth besueshmërisë së qytetarëve në institucione. Mirëpo, kur jemi tek besimin ndaj në institucionet e drejtësisë, besimi i qytetarëve bazohet edhe në faktorë dhe elemente të ndryshme përtej përvojës personale. Për më shumë, besimi i ulët në sistemin e drejtësisë mund të jetë i ndërlidhur me punën dhe aktivitetet e këtyre institucioneve,

përkatësisht mungesën e rezultateve konkrete të sektorit të drejtësisë në përgjithësi sa i përket luftimit të korrupsionit, kapjes së shtetit, krimit të organizuar dhe dukurive të tjera kriminale që vazhdojnë të dëmtojnë zhvillimin e shtetit dhe sundimin e ligjit në vend në veçanti.¹²

Në bazë të perceptimeve të të anketuarve për vitin 2019, vetëm 21 përqind e tyre janë shprehur se kanë shumë besim në Gjykatat e Kosovës. Gati gjysma e të anketuarve (ose 43 përqind) kanë shprehur rezerva, duke u deklaruar se i besojnë këtyre institucioneve deri diku. Në anën tjetër, 33 përqind e të anketuarve të tjerë kanë thënë se nuk i besojnë fare Gjykatave. Nga analizat e kombinuara është parë se në zonat rurale ka një besueshmëri lehtësisht më të lartë në Gjykata se në zonat urbane. Ndërsa, rezultatet në bazë të përkatësisë etnike tregojnë se të anketuarit nga radhët e komunitetit serb në Kosovë kanë më së paku besim në Gjykatat e Kosovës në krahasim me të anketuarit shqiptarë si popullatë shumicë në Kosovë dhe komunitetet tjera pakicë jo-serbe në vend. Gjithashtu, BKS ka regjistruar se gratë kanë besim më të lartë në Gjykata se burrat.


11 Lexoni më shumë rreth besueshmërisë ndaj Institucioneve të Drejtësisë së BKS 2018 në http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2018-SHQIP_853983.pdf

12 Raporti "Dështimet speciale në luftimin e korrupsionit" i Institutit të Kosovës për Drejtësi ofron një shpjegim të detajuar të punës jo të kënaqshme të Sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial në luftimin e korrupsionit e posaqërisht të korrupsionit të profilit të lartë. Raporti i çashtëm në: <https://kli-ks.org/deshtimet-speciale-ne-luftimin-e-korrupsionit/>


Të dhënat e BKS për vitin 2019 kanë vënë në pah se Prokuroria gëzon besim më të kënaqshëm nga ana e publikut në krahasim me Gjykatat; megjithëse, niveli i besueshmërisë është i ulët edhe në Prokurori. Rrjedhimisht, rreth 29 përqind e të anketuarve janë shprehur se i besojnë lartësisht Prokurorisë, ndërsa 41 përqind prej tyre kanë shprehur besim jo të

kënaqshëm në këtë institucion. Ndërkaq, 29 përqind e të anketuarve janë shprehur se nuk i besojnë aspak punës që bën Prokuroria në Kosovë. Ngjashëm me besueshmërinë ndaj Gjykatave, besim më i lartë në Prokurori është vërejtur në rajonin e Gjakovës si dhe tek të anketuarat gra.


Besimi në GJKATA




Besimi në PROKURORI



Besimi në Gjykata sipas gjinisë



Besimi në Prokurori sipas gjinisë



Besimi në Gjykata sipas vendbanimit

Zona rurale
20.4%



Deri Diku 44.3 %
Aspak Besim 31.1 %

Zona urabne
23.0%



Deri Diku 43.3 %
Aspak Besim 35.8 %

Zona rurale
29.0%



Deri Diku 41.2 %
Aspak Besim 27.3 %

Zona urabne
28.0%



Deri Diku 40.3 %
Aspak Besim 30.2 %

Besimi në Institucionet e Drejtësisë sipas kombësisë


Shqiptarë




Serb



Të tjerët



Besimi në Institucionet e Drejtësisë sipas rajonit



1.3 BESUESHMËRIA NË KUVEND, QEVERI DHE KOMUNA

Edhe këtë vit, BKS ka bërë matjen e perceptimeve të qytetarëve ndaj institucioneve kryesore të nivelit qendror dhe lokal të zgjedhura në mënyrë demokratike në Kosovë. Ngjashëm me edicionet e kaluara, fokusi kryesor i kësaj pjese të hulumtimit ishte matja e perceptimeve të qytetarëve për Qeverinë, Kuvendin si dhe Komunitetet e Kosovës.

Këto tri institucione kyçe zënë një vend të rëndësishëm në BKS duke pasur parasysh rolin aktiv të tyre lidhur me sektorin e sigurisë dhe drejtësisë. Po ashtu, këto tri institucione janë drejtpërdrejtë përgjegjëse për të ofruar siguri socio-ekonomike për qytetarët dhe si të tilla, matja e perceptimeve të qytetarëve ndaj këtyre institucioneve është një objektiv tejet i rëndësishëm i këtij raporti. Përkundër mandatit të tyre kushtetues e ligjor, të dhënat e BKS tregojnë se besueshmëria ndaj këtyre institucioneve vazhdon të mbetet shumë e ulët (veçanërisht ndaj QK dhe KK) dhe qytetarët në përgjithësi nuk kanë treguar perceptim pozitiv pavarësisht se vërehet rritje e lehtë e besimit në raport me vitin 2018. Për më tepër, QK dhe KK vazhdojnë të mbesin ndër institucionet që kanë më së paku besueshmëri në 2019 edhe kur rezultatet krahasohen me të gjitha institucionet tjera të analizuar më sipër në këtë raport.

Qeveria e Kosovës ka më së paku besim nga të gjitha institucionet që BKS 2019 ka matur.¹³ Ngjashëm me vitin e kaluar, vetëm 16 për qind e të intervistuarëve kanë shprehur besimin e tyre në Qeverinë e Kosovës. Në anën tjetër, gati gjysma ,45 për qind, të të anketuarëve kanë thënë se nuk i besojnë aspak Qeverisë së Kosovës. Një besueshmëri kaq e ulët mund të ketë ardhur si rrjedhojë e skandaleve të shumta të Qeverisë së fundit që lidhen me abuzimin e shpenzimit të parasë publike si numri i madh i zëvendësministrave e këshilltarëve. Madje, Qeveria ka vazhduar të merr vendime të ndryshme, që mund të jenë jo-ligjore dhe potencialisht edhe abuzim i detyrës zyrtare, edhe pas dorëheqjes së ish-Kryeministrit Haradinaj.¹⁴ Po ashtu, siç duket, një besueshmëri kaq e ulët ndaj Qeverisë duket se është indikator kyç për migrimet e të rinjëve (krahas arsyeve socio-ekonomike).

Mirëpo, vërehet se ka pasur një rritje të vogël të besueshmërisë nga 14 për qind në 2018 në 16 për qind në 2019. E këtu ka mundur të ndikoj ndoshta vendosja e taksës ndaj produkteve serbe dhe boshnjake, transformimi i FSK-së si dhe pozicionimit kundër shkëmbimit të territoreve. Megjithatë, një rritje e tillë është e papërfillshme dhe siç duket vendime të tilla nuk e kanë shpëtuar këtë Qeveri nga perceptimet negative.

13 Responentët janë pyetur për Qeverinë dhe Kuvendin ekzistues para zgjedhjeve të 6 tetorit

14 Gjatë muajit korrik ish-kryeministri në dorëheqje kishte thirrur për mbledhjen e rregullt dhe Ministrinë e ndryshme vazhduan të merrnin vendime. Lexoni më detajisht në <https://telegafi.com/kryeministri-ne-doreheqje-therret-mbledhjen-e-qeverise-per-te-premten-haxhiu-e-quan-skandaloze/> dhe <https://telegafi.com/sa-jane-legjitime-vendimet-e-qeverise-pas-doreheqjes-se-haradinajt/>


Ngjashëm me Qeverinë, vetëm 18 përqind e të anketuarve i besojnë Kuvendit, ndërsa vërehet se ka një rritje të besimit në këtë institucion prej tre përqind në raport me vitin 2018.¹⁵ Megjithatë, 41 përqind prej tyre kanë deri diku besim në Kuvend dhe 40 përqind të tjerë janë shprehur se nuk i besojnë fare Kuvendit. Kjo mund të shpie në vlerësimin se qytetarët janë jashtëzakonisht të pakënaqur me punën e këtij institucioni në përgjithësi dhe të deputetëve të legjislaturës së gjashtë të KK në veçanti.

Një besim kaq i mangët i qytetarëve krahas këtyre institucioneve mund të ketë ardhur si me gjendjen e dobët ekonomike të vendit, izolimin aktual të Kosovës- ngecja e procesit të liberalizimit të vizave, integritimit evropian¹⁶, dialogut me Serbinë dhe mos-anëtarësimi në organizata dhe mekanizma ndërkombëtare.


Kjo mungesë e besimit në këto dy institucione themelore është alarmante dhe tregon se këto institucione kanë dëshuar t'u dëshmojnë qytetarëve se janë duke punuar mjaftueshëm për të bërë Kosovën një vend më të mirë për të jetuar. Mirëpo, një qasje tjetër vërehet ndaj institucionet lokale.

Institucionet lokale, gjegjësisht Komunitat e Kosovës, vazhdojnë të jenë dukshëm më të besueshme se ato qendrore. Rreth 41 përqind e të anketuarve kanë shprehur besim e tyre të lartë në Komuna. Ndërsa, 40 përqind të tjerë kanë besim të një shkalle më të ulët në institucionet komunale. Sipas hulumtuesve në terren, niveli i besueshmërisë në Komuna dhe perceptimi pothuajse pozitiv ose i moderuar i të anketuarve në këto institucionet lokale ndërlidhet kryesisht me shërbimet të cilat ofrohen nga Komunitat.¹⁷


Besimi në Qeverinë e Kosovës



Besimi në Kuvendin e Kosovës



Besimi në Institucionet lokale




15 Lexoni më detajisht rreth besueshmërisë ndaj Kuvendit të Kosovës në BKS 2018 <http://www.qkss.org/sq/Raportet/Barometri-Kosovar-i-Sigurise-Edicioni-i-tete-1163>


16 Pas rënies së Qeverisë së Republikës së Kosovës, 46 projektligje kanë mbetur në procedurë të shqyrtimit nga komisionet parlamentare, qoftë në lexim të parë ose lexim të dytë. Projektligje këto prioritare në kuadër të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA). Lexoni këtë artikull për më shumë detaje;

17 Të dhënat nga Fokus Grupi për BKS 2019, tetor, Prishtinë


Besimi në QK sipas gjinisë




Besimi në QK sipas vendbanimit




Besimi në QK sipas kombësisë




Besimi në QK sipas rajonit




Besimi në KK sipas gjinisë




Besimi në KK sipas vendbanimit




Besimi në KK sipas kombësisë




Besimi në KK sipas rajonit






Besimi në Komuna sipas gjinisë




Besimi në Komuna sipas vendbanimit



Besimi në Komuna sipas rajonit



Besimi në Komuna sipas kombësisë



Besueshmëria në Institucione Qendrore sipas Të ardhurave Mujore



Kuvendi i Kosovës



Qeveria e Kosovës



Komunat



PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT NË INSTITUCIONET E KOSOVËS

Krahas matjes së besueshmërisë në institucione, BKS 2019 ,si edhe në edicionet paraprake, ka bërë matjen e perceptimeve të qytetarëve se sa janë të korruptuara institucionet e sigurisë, drejtësisë si dhe ato komunale. Mirepo, ndryshe nga edicionet e kaluara kësaj here ky sesion lancohet si pjesë përbërëse e edicionit të rregullt të KSB, si një kapitull i veçantë. Andaj, në kuadër të këtij kapitulli shpalosen perceptimet e qytetarëve ndaj korrupsionit duke u fokusuar në institucione kyçe të sigurisë si PK, FSK, DK, SHKK; drejtësisë -Gjykata e Prokurori si dhe korrupsionit në Komuna. Sipas gjetjeve të BKS 2019, siç duket, ka një lidhshmëri në mes të besueshmërisë në institucione dhe perceptimeve të korrupsionit. Krahas kësaj, rezulton se institucionet e sigurisë si ma të besueshme perceptohen si më pak të korruptuara, ndërsa sektori i drejtësisë që ka besueshmërinë më të ulët perceptohet si thellësisht i korruptuar nga më shumë se gjysma e të anketuarve.

Të dhënat e BKS për vitin 2019 dëshmojnë se institucionet e drejtësisë, sipas perceptimeve të të anketuarve, janë më të korruptuarat në vend.¹⁸ Më shumë se gjysma të anketuarve i perceptojnë Gjykatat dhe Prokurorinë si të korruptuara. Prandaj, Gjykatat kanë rezultuar të jenë institucioni më i korruptuar në Kosovë, marrë parasysh se më shumë se gjysma e të anketuarve ose 53 përqind e tyre, kanë deklaruar se gjykatat janë të korruptuara. Pas tyre radhitet Prokuroria, me 51 për qind të të anketuarve që ndajnë perceptimin se ky institucion është i korruptuar. Kjo përputhet edhe me besueshmërinë e publikut meqë këto dy institucione kanë

besimin më të ulët nga të anketuarit në krahasim me institucionet e sigurisë.

Pas Gjykatave e Prokurorisë, institucioni i tretë më i korruptuar nga të anketuarit konsiderohet DK, gjegjësisht 38 përqind prej tyre i perceptojnë doganat si të korruptuara. Ndërkohë, Komunat e Kosovës edhe pse renditen si institucione më pak të korruptuara sesa ato që u përmendën më lartë, vërehen dallime të dukshme kur rezultatet krahasohen me ato të vitit 2018. Mund të thuhet se trendi i perceptimeve për korrupsionin në Komuna është negativ marrë parasysh që ka rritje prej shtatë përqind sa i përket korrupsionit – ku nga viti 2018 në 29 përqind ka shënuar rritje në 36 përqind në vitin 2019.¹⁹ Për më tepër, gjatë vitit 2018 Komunat ishin konsideruar ndër institucionet që ishin më së paku të prekurra nga fenomeni i korrupsionit sipas përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit.

Nga ana tjetër, institucionet e sigurisë shihen si më së paku të korruptuara nga të anketuarit. Në këtë rast prin FSK ku vetëm rreth 5 përqind prej tyre kanë shprehur mendimin se ky institucion i mbrojtjes është i korruptuar. Në vendin e dytë pas FSK është PK nga rreth 25 përqind e të anketuarve që i shohin forcat e rendit si të korruptuara dhe në krahasim më vitin 2018 vërehet një rënie prej katër përqind në perceptimet e publikut për korrupsionin në polici.²⁰ Ndërkaq, SHKK

18 BKS nuk i ka pyet të anketuarit për perceptimet e tyre për korrupsionin në Qeverinë e Kosovës si dhe në Kuvendin e Kosovës

19 Avdiu, P. (2018) "EDICION SPECIAL I BKS-SË - KORRUPSIONI, SUNDIMI I LIGJIT DHE INTEGRITETI POLICOR NË KOSOVË" I çasshëm në <http://www.qkss.org/sq/Raportet/Edicion-Special-i-BKS-se-Korrupsioni-Sundimi-i-ligjit-dhe-Integriteti-Policor-ne-Kosove-1211>

20 Po aty;

nuk qëndron larg PK-së, më saktësisht rreth 26 përqind e të anketuarve janë përgjigjur se ajo është e korruptuar duke

u renditur kështu si institucioni i tretë më pak i korruptuar gjatë vitit 2019 pas FSK dhe PK.

Institucionet më të Korruptuara



Forca e Sigurisë së Kosovës



Policia e Kosovës



Shërbimi Korrektues i Kosovës



Komunat



Doganat e Kosovës




Prokuroria e Kosovës




Gjykatat




Përceptimi i Korrupsionit në Gjykata




Përceptimi i Korrupsionit në Prokurori




Përceptimi i Korrupsionit në Dogana




Përceptimi i Korrupsionit sipas rajonit - shumë e korruptuara




Përceptimi i Korrupsionit në Komuna




Përceptimi i Korrupsionit në SHKK




Përceptimi i Korrupsionit në PK



Përceptimi i Korrupsionit në FSK



Përceptimi i Korrupsionit sipas rajonit -shumë e korrupuara



METODOLOGJIA

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) i krijuar në shtator të vitit 2012. Qëllimi i tij kryesor është që të mat besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë si dhe të mat perceptimin e qytetarëve lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme që i kanosen Kosovës.

BKS është aktiviteti i parë dhe më i madhi i këtij lloji i dizajnuar, zbatuar dhe komunikuar nga një forum lokal në Kosovë. Duhet theksuar se ajo që e bën unik BKS në Kosovë është neutraliteti i tij politik. Si një forum i pavarur, QKSS nuk ka kufizime politike në komunikimin e çfarëdo gjetjeje dhe mesazhi të hulumtimit.

BKS përdor kombinim të metodave cilësore dhe sasiore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat e tij mbledhen përmes intervistave personale me të anketuarit e përzgjedhur në mënyrë të rastësishme që zhvillohen nga hulumtuesit e QKSS në terren anembanë Kosovës. Pyetësi i QKSS përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të Shkallës pesë-pikëshe të Likertit, që pasoheshin me disa pyetje të hapura që u mundësonin të anketuarve të japin mendimet e tyre pa u dhënë opsione të paracaktuara të përgjigjeve.

Ekipi i QKSS prej 29 hulumtuesve ka bërë pilotimin dhe intervistat. Mostra në nivel vendi nga të cilat u nxor ky hulumtim përfshinte 1,189 familje, duke përbërë kështu një mostër përfaqësuese të popullsisë mbi moshën 18 vjeçe në Kosovë. Përkatësia etnike e personave të intervistuar ishte: 89 për qind shqiptarë të Kosovës, 7.4 për qind serbë dhe 2 për qind të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptian dhe goran) që reflektonin përbërjen etnike të Kosovës. Korniza e mostrës bazohej në zona sipas kodeve hyrëse telefonike dhe si e tillë përfshinte këto tetë rajone: Ferizajn, Gjakovën, Gjilanin, Mitrovicën Jugore, Mitrovicën Veriore, Pejën, Prishtinën dhe Prizrenin.

Faza e parë e grupimit gjeografik bazohej në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë 2012. Faza e dytë përfshinte grupimin e mostrave për zona komunale me mostër të stratifikuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit u zhvillua sipas metodës së caktimit të rastësishëm të mostrës duke përdorur 'metodën e ditëlindjes' më të afërt.


Caktimi i rastësishëm i mostrës siguron që secili banor i Kosovës të ketë gjasë të barabartë që të zgjidhet për intervistë. Me mostrën e zgjedhur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendët e qëndrimeve dhe perceptimeve në mesin e tërë popullsisë së rritur të Kosovës në përgjithësi.

Margjina e gabimit është 3 për qind me interval të besueshmërisë prej 95 përqind.


Një intervistë testuese u zhvillua në fund të muajit shtator për të testuar sa është i plotë pyetësi para fillimit të punës në terren. Ekipi hulumtues pastaj raportoi se intervista testuese ishte e suksesshme dhe se nuk ishin hasur prob-

leme me instrumentin testues. Të gjitha intervistat u kryen nga 9 tetor deri më 16 tetor 2019. Të dhënat u përpunuan dhe analizuan duke përdorur softuerin SPSS.


Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmblendje e informacioneve të marra nga të anketuarit dhe ai demonstroi se si njerëzit i perceptojnë institucionet kosovare.




Të anketuarit sipas gjinisë




Të anketuarit sipas Zonës së Vendbanimit



Hulumtimi në terren



Mosha



Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

355.45(496.51)(047)

Marku, Donika

Barometri kosovar i sigurisë : edicioni i nëntë
/ Donika Marku. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2019. – 36
f. : ilustr. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-679-98-5

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-98-5



9 789951 679985